



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2025

V E N D I M

Nr. ____ datë _____.____.2025

PËR

**MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT PROJEKT-
RREGULLORE “PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 22 dhjetor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it, miratuar me vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt”:

- “Miratimin për këshillim publik të dokumentit Projekt-Rregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm””.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 8 e nenit 27 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë, si më poshtë:

1. Dokumenti për këshillim publik: Projekt-Rregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”;
2. Projektvendimi i arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit;

si dhe referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke arsyetuar në mbështetje të bazës ligjore referuese,

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” ka hyrë në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar Direktivën (EU) 2018/1972 të parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (në vijim EECC).
2. Projektakti siguron zbatimin praktik dhe të harmonizuar të dispozitave të neneve 12, 13 dhe 16 si dhe Aneksit 1 të Direktivës (EU) 2018/1972 me nenet 20, 26, 27, 29 dhe 30 të ligjit nr. 54/2024, të cilat rregullojnë regjimin e autorizimit të përgjithshëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
3. Mbështetur në parashikimet e reja të ligjit nr. 54/2024, të sipërcituar, është synuar që të miratohet me rregulloren “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, forma dhe përmbajtja e njoftimit, dokumentacioni mbështetës si dhe konfirmimi i regjistrimit të njoftimit, duke marrë në konsideratë rekomandimet e BEREC dhe ITU, parashikimet e akteve të tjera ligjore e nënligjore që prekin apo ndërthuren me fushën e komunikimeve elektronike, të tilla si:
 - Ligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
 - Ligji “Për lejet e mjedisit”;
 - Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”;
 - Ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
 - Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit”;
 - Akte nënligjore
 - Rregullore të AKEP
4. Në përputhje me përcaktimet e pikës 8 të nenit 27 dhe pikës 3 të nenit 191 të ligjit nr. 54/2024, AKEP, ka përgatitur dokumentin Projekt-Rregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, i cili do të jetë objekt i këshillimit publik me palët e interesuara.
5. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe Rregulloren “Për procedurat e njoftimit

dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim nr.21, datë 7.12.2021, të Këshillit Drejtues të AKEP, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit Projekt-Rregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 45 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 të këtij vendimi.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik “Projekt-Rregullore për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Lorenc Bako	Armer Juka